

**“EFEKTET E PANDEMISË COVID 19 NË SHËNDETIN MENDOR TE
PACIENTËT E KOSOVËS“**

**(Rastet, Qendra Klinike Universitare e Kosovës dhe Spitali Regjional “Isa Grezda” në
Gjakovë)**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SOCIOLOGJISË
NGA**

VLORA KRASNIQI

EKSPOZE E PUNIMIT TË TEMËS SË MASTERIT



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

Departamenti i Sociologjisë

Mentori :

Prof. Asoc. Dr. Fadil Maloku

Prishtinë, 2022

Përshkrimi i shkurtër i punimit (qëllimi)

Ky punim synon të analizojë efektet që vijnë nga përhapja e pandemisë së Coronavirusit (COVID-19) në Republikën e Kosovës, ndikimin e tij në shëndetin mendor të pacienteve kosovarë ku konkretisht hulumtimi është bërë me pacientët e Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë dhe me pacientët e Spitalit Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë.

Me pacientët e këtyre dy institucioneve shëndetësore është bërë një pyetësor i cili ka përmbajtur 10 pyetje, rreth njohurive për Coronavirusin, nga njohja e tij si virus i ri për mbarë botën, simptomat të cilat shfaqen, pasojat e tij dhe mënyrës me të mirë për tu mbrojtur nga ai.

Përveç pyetësorit me pacientë është bërë edhe intervista me mjekët specialist të fushës përkatëse si dhe me stafin e mesëm shëndetësor, ku kryesisht pyetësi dhe intervista kanë përmbajtur, pyetje që lidhen drejtpërdrejtë me pacientet që vuajnë nga problemet e shëndetit mendor nga gjendja post covid.

Punimi është strukturuar në shtatë kapituj

Kreu I. PËRKUFIZIMI DHE HISTORIKU Covidit19

Në këtë kapitull janë marrë të dhënat e përgjithshme rreth Cov-19 analizuar, studiuar dhe interpretuar si dhe familjes së koronavirusëve në përgjithësi, po ashtu është hulumtuar për historikun e pandemive të ndryshme neper botë e në veçanti kemi analizuar dhe hulumtuar për pandeminë e shekullit 21 e cila e kaploi të gjithë botën.

Kreu II. TRENDI I COVID19

Në këtë kapitull është diskutuar për efektet e pandemisë në botë, ndikimi i saj në shëndetin mendor të pacienteve, efektet e saj në ekonomi, në jetën sociale si dhe masat të cilat janë marrë nga qeveritë e ndryshme për të ngadalësuar përhapjen e virusit si dhe përmirësimin e jetës sociale dhe efekteve afatgjata të pandemisë në përgjithësi.

Kreu III. DISTANCA SOCIALE DHE DISTANCA FIZIKE

Në këtë kapitull është analizuar në mënyrë të detajuar rreth kësaj pandemie se Coronavirusi a ka shkaktua distancë fizike e jo sociale, si te respektohet distanca sociale dhe fizike si dhe janë marr mendimet e Prof. Asoc. Dr. Fadil Maloku dhe autoreve të tjerë botëror se cilat janë pasojat ne jetën sociale të kësaj pandemie.

Kreu IV. SHKAQET E COVIDIT 19

Në këtë kapitull është folur nga ekspertet te lëmive dhe janë analizuar dhe interpretuar te dhënat e nxjerra për Cov-19 çështje të rëndësishme si: A janë simptomat e njëjta si të gripi i zakonshëm si të Covidit? Sa i rrezikshëm është ky virus? Sa zgjatë periudha e inkubacionit dhe shume informacione të tjera.

Kreu V. PASOJAT E COVIDIT

Në këtë kapitull janë nxjerr informacione si ky virus përhapet me gjerë dhe me shpejt në krahasim me viruset e tjerë, , paniku dhe shqetësimet qe i ka shkaktuar, e ardhmja e paparashikueshme nga mite dhe dezinformata, të gjitha këto si dhe shume pasoja tjera stresuese qe mund te kenë efekte afatgjate post pandemike.

Kreu VI. PËRPUNIMI I REZULTATEVE

Në këtë kapitull i kemi paraqitur tabelat dhe rezultatet e dala pas kryerjes se pyetësorëve dhe intervistave me pacientet, stafin e mesëm shëndetësor dhe specialistet e fushës.

Kreu VII. VERIFIKIMI I HIPOTEZAVE DHE PËRFUNDIMET E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull kemi dokumentuar reagimin e institucioneve shëndetësore ne Kosovë ndaj pandemisë me te rëndësishme te shekullit 21, efektet e kësaj pandemi ne shëndetin mendor te pacienteve, pasojat e shkaktuara qofshin ato afatshkurtre e deri te ato afatgjate socio -ekonomike dhe financiare ne te ardhmen, duke përfshirë edhe ndërlikime morale e etike edhe te demokracisë.

Gjate këtij punimi synohet te arrihet një informim sa me i mire dhe konkret mbi praktikat për parandalimin e bartjes se CoV-19, respektivisht duke respektuar rekomandimet për distancim

social dhe trajnimin e punonjësve që ti njohin simptomat e CoV-19 dhe ta kuptojnë reagimin e kërkuar prej tyre, ku nga rastet e mëparshme të përhapjes së sëmundjeve kanë treguar që shpërndarja e informacionit dhe trajnimi janë një mënyrë më e mirë dhe efektive për ta zvogëluar rrezikun për shëndetin e përgjithshëm të popullatës.